



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



BASHKIA FUSHË - ARRËZ
Nr. 1298 prot. Dt. 05.05.25
Ref: KB, Financa
09/05/2025

Nr. 326/1 prot.

Shkodër, më 05.05.2025

[Signature]

Lënda: Mbi Vendimin nr. 13, datë 28.04.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të nryshuar, neni 24, neni 53, pika 6, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i ndryshuar, të VKB Fushë Arrëz nr. 2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”, shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 13, datë 28.04.2025 “Për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Mars 2025 për njësitë administrative, Fushë Arrëz, Iballë, Qafë Mali, Blerim dhe Fierzë”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni për trajtimin e 31 familjeve në shumën 120 808 lekë, duke përdorur deri në 6% të fondit total të ndihmës ekonomike prej 2 040 515 lekë për muajin Mars 2025.

☐ uke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

[Signature]
Majlinda ANGONI